



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:096119

Datë: 01.08.2023

Numri i dokumentit: 04544095

**C.nr.2076/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit D.S. me numër personal .... nga fshati .... Komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson M.Q. avokat nga Prizreni, kundër të paditurit B.F. me numër personal .... nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson N.E. avokat nga Prizreni, me objekt kontesti pasurim i pabazë, vlera e kontestit 9,000.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datën 19.07.2023, në prezencë të paditësit dhe të autorizuarit të tij, si dhe të autorizuarit të paditurit, mori, ndërsa me datën 01.08.2023, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **Aprovohet pjesërisht** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit D.S. nga fshati .... Komuna e Suharekës.
- II. **DETYROHET** i padituri B.F. nga Prizreni, që në emër të pasurimit të pabazë ti kthej paditësit D.S. nga fshati .... komuna e Suharekës, shumën prej 4,000.00 (katërmijë) euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e paraqitjes së padisë 31.12.2018, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin prej 15 ditë pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. **Refuzohet** pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit D.S. nga fshati .... komuna e Suharekës, në shumë prej 5000 euro.
- IV. **DETYROHET** i padituri B.F. nga Prizreni, që paditësit ti paguaj shpenzimet e procedurës, në shumën prej 771.50 (shtatëqind e shtatëdhjetenjë) euro, në afatin prej 15 ditë pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi D.S. nga fshati .... komuna e Suharekës, përmes të autorizuarit të tij M.Q. avokat nga Prizreni, me datë 31.12.2018, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit B.F. nga Prizreni, për shkak të pasurimit të pabazë, vlera e kontestit 9,000.00 euro.

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i paditësi, në padinë e paraqitur ka theksuar se paditësit D.S. punon si menaxher në pikën e shitjes së karburanteve “Spahija Petrol”, në lagjen Arbana, në të cilën janë njohur edhe me të paditurin dhe kanë pasur raporte të mira. Gjatë vitit 2016, i padituri disa herë i ka kërkuar të holla borxh e po ashtu paditësi nga i padituri ka blerë edhe automjete. Në fund të vitit 2016, me qëllim të barazimit të borxhit që kishte i padituri ndaj paditësit, merren vesh mes vete që i padituri B. të ia jep automjetin e tipit Audi A3, të cilin e kishte blerë nga Sh.S. në vlerë prej 8.000 euro. Paditësi i kishte paguar shumën prej 4000 euro, të njëjtën ditë kur kishte marrë automjetin, ndërsa shuma tjetër prej 5000 euro është kompensuar për borxh. Pas kësaj marrëveshje, paditësi e kishte marr në posedim automjeti dhe ia kishte shitur T.Th. ndërsa i padituri me qëllim të përfitimit të pabazë dhe për të iu shmangur obligimeve që kishte ndaj paditësit dhe personave të tjerë e paraqet rastin në polici, kërkon ti kthehet automjeti dhe gjatë procedurës penale i njëjti ka ndryshuar deklaratat dhe ka arritur që të kthej automjetin e njëkohësisht të mbaj edhe shumën që e kishte pranuar në emër të shitblerjes, pra shumën prej 4000 euro, si dhe borxhin paraprak që kishte në shumën prej 5000 euro, duke bërë kështu që i padituri të pasurohet pabazë në shumën prej 9.000 euro. Në fund gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave, të merr vendim dhe padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, i autorizuari i paditësit ka qëndruar në tërësi pranë kërkesëpadiësë, ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim në shqyrtimin kryesor të datës 19.07.2023, ka theksuar se pas administrimit të provave në këtë çështje kontestimore janë vërtetuar tërësisht pretendimet e paditësit të parashtruara me padi, kundër të paditurit B.F. për pasurim të pabazë, pasi që paditësi është varfëruar në shumën prej 9000 euro. Nga formulari i dorëzimit të sendeve të datës 25.01.2017, vërtetohet se automjeti i është dorëzuar të paditurit B.F. edhe përkundër faktit se procedura penale nuk kishte përfunduar, ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML.nr.314/21, të datës 29.12.2021, me të cilin vërtetohet se paditësi është liruar nga aktakuza, duke u shpallë i pafajshëm, me përshkrimin se ai nuk ka kryer vepër penale për të cilin ngarkohet dhe nuk i kishte shkaktuar asnjë dëm material të dëmtuarit, përkundrazi kthimi i automjetit që i takonte paditësit, të njëjtin e kishte dëmtuar në shumën e përshkruar në padi e që është vërtetuar edhe nga vet deklarimi i të paditurit në këtë procedurë, i cili nuk e kishte kontestuar faktin se automjeti i sekuestruar i ishte kthyer ati. Ndaj, në këto rrethana dhe bazuar në provat e administruara është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadiësë, gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadija e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 974 euro, të specifikuara si në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim.

I padituri B.F. nga Prizreni, në këtë çështje kontestimore nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore, i autorizuari i të paditurit N.E. avokat nga Prizreni, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa në fjalën përfundimtare ke theksuar se në bazë të provave të prezantuara, kërkesëpadia e paditësit nuk ka bazë ligjore, ndaj edhe gjykatës i ka propozuar që të njëjtën ta refuzojë si të pa bazë. Është fakt evident se palët ndërgjygjëse kanë pasur një punë juridike të lidhur mes vete, se i paditurit ka pranuar shumë në lartësi prej 7200 euro, por që borxhi ka mbetur statik por që i padituri është dashur që në emër të kontraktimit jo proporcional paditësit në muaj ti paguajë shumë në lartësi prej mbi 1300 euro. Nga fakti se paditësi ka kërkuar jo kthimi e kryegjësë por pagimin e shumë në emër të kontraktimit jo proporcional i padituri është detyruar që në emër të këtij kontraktimi paditësit t'ia dorëzoj automjetin "Cady" që ka pasur vlerë analoge me kryegjënë e kurrsesi të trajtohet si çmim në emër të kontraktimit jo proporcional. Në këto rrethana nga momenti i lidhjes së kësaj pune të pa ligjshme juridike gjerë në momentin e përplasjes së rastit penal i padituri në mënyrë selektive ka kompensuar shumë mbi 13,000.00 euro dhe atë në emër të kontraktimit jo proporcional ndërsa në momentin kur kryegjëja ka mbetur e pa prekur paditësi ka kërkuar një automjet të tipit "Audi A3" si arsye që gjysma e vlerës të trajtohet si kryegjë ndërsa gjysma tjetër si borxh. Nga fakti se vet puna juridike konsiderohet si punë e pa ligjshme fakti se i padituri ka paguar shumë përtej borxhit kryesor dhe atë në trefishin e borxhit kryesor, në këto rrethana i padituri është dëmtuar përtej mase dhe nga krejt shuma e kompensuar në drejtim të përmbushjes së detyrimit, kap vlerën në të holla në shumë mbi 20.000 euro. Në këto rrethana, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në shumë prej 890 €, të specifikuara si në fjalën përfundimtare.

## 2. Gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: dëgjimi në cilësi të palës i paditësit D.S. në shqyrtimin kryesor të datës 06.04.2023; dëgjimi në cilësi të palës i të paditurit B.F. në shqyrtimin kryesor të datës 29.06.2023; kontratën mbi shitblerjen e automjetit të datës 17.08.2016, e lidhur në mes të Sh.S. dhe B.F. Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me numër PML.nr.314/2021, të datës 31.01.2022; evidencën e lëshuar nga Policia e Kosovës e datës 25.01.2017, së bashku me certifikatën për regjistrimin e automjetit me numër të targave 04-960-FB; vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve; procesverbalin mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit – dëshmitarit, e dhënë në prokurori me numër PP/II.nr.94-6/17, të datës 25.01.2017; procesverbalin mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit – dëshmitarit, e dhënë në prokurori me numër PP/II.nr.94-6/17, të datës 07.02.2017; procesverbalin mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit – dëshmitarit, e dhënë në Policinë e Kosovës, me datë 18.01.2017; procesverbalin mbi marrjen në pyetje të të pandehurit, me numër PP/II.nr.94-6/17, të datës 09.02.2017; procesverbalin mbi intervistimin e të dyshuarit, e përpiluar pranë Policinë e Kosovës, me datë 18.01.2017.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se:

*Kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.*

Gjykata, në shqyrtimin kryesor të datës 06.04.2023, ka bërë dëgjimin në cilësi të palës të këtu paditësit D.S. i cili ka deklaruar se “unë kam një biznes familjar në lagjen Arbana, unë me B. kamë pasur raporte të mira shoqërore, disa herë kamë kryer servisin e automjeteve tek servisi i B., B. më ka kërkuar disa herë para – hua deri tek vlera prej 9000 eurove, pas një kohe ka ardhur në restorant rreth vitit 2016 dhe në vend të hollave të cilat i kishte borxh më ka ofruar automjetin të tipit “Audi A3”, unë të njëjtit automjet e kamë shitur Sh.K., B. ka ftuar Sh. dhe të njëjtit ka njoftuar se automjeti nuk mund të bartet pronësia mbi të, Sh. më ka kthyer automjetin, më pas të njëjtit automjetin kam shitur personit të tretë, më pas B. ka lajmëruar rastin në polici me pretendimin se automjeti është marr me dhunë dhe me fajde, automjetin e tipit “Audi A3” unë e kamë dorëzuar në polici dhe automjeti asnjëherë më nuk më është kthyer”. Pas pyetje të bërë nga i autorizuari i paditësit dhe i autorizuari i të paditurit, paditësi D.S. ka deklaruar se pas konfiskimit të automjetit nga policia i njëjti i është kthyer këtu të paditurit, ndërsa pagesa e borxhit nuk i është bërë. Po ashtu ka deklaruar se shuma të cilën ia kishte dhen hua të paditurit është në lartësi prej 9000 euro, e për të cilat nuk ka ndonjë vërtetim me shkrim pasi që kanë pasur raporte shoqërore mes tyre.

Gjykata, në shqyrtimin kryesor të datës 29.06.2023, ka bërë dëgjimin në cilësi të palës të këtu të paditurit B.F. i cili ka deklaruar se “se unë me D.S. kemi pasur raportet shoqërore të njëjtin e kamë pasur shok, të njëjtit unë i kamë shitur disa vetura dhe automjeti i fundit të cilën ja kamë shitur ka qenë Audi A3, por të njëjtit konsiderojë se nuk i kamë borxh”. Pas pyetje të bërë nga i autorizuari i të paditurit dhe i autorizuari i paditësit, i padituri ka deklaruar se të hollat nga këtu paditësi i kishte marrë në formë të fajdes, duke theksuar se automjetin Audi A3 e kishte dhënë për pagesën e fajdes dhe 4000 euro i ishin dhënë kesh nga ana e paditësit dhe se pas sekuestrimit automjeti Audi A3 i ishte kthyer këtu të paditurit nga ana e policisë. Ndërsa për shumën prej 4000 euro, i njëjti ka deklaruar se e ka marrë nga këtu paditësi për shkak të blerjes së automjetit Cady.

Nga leximi i kontratës mbi shitblerjen e automjetit të datës 17.08.2016, gjykata vërtetoi faktin se pranë zyrës së Avokat B.N. në Prizren, ishte lidhur kontrata interne në mes të Sh.S. dhe këtu të paditurit B.F. dhe objekt i kësaj kontrate është automjeti Audi, tipi A3 2.0 TDI, me targa 04-960-FB, ngjyrë hiri metalik, me numër të shasisë WAUZZZ8P57A128609, viti 2006.

Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër PML.nr.314/2021, të datës 31.01.2022, gjykata vërtetoi faktin se ishte aprovuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë së mbajtësit së të dënuarit - këtu paditësit D.S. është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, me numër P.nr.134/019, i datës 12 shkurt 2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.450/2021, i datës 14 qershor 2021, ashtu që

Gjykata Supreme e Kosovës, konform dispozitave së nenit 364 par.1, pika 1.3 të KPP e liron nga akuza, për shkak se nuk është provuar se është kryer vepra penale fajdeja, e parashikuar me nenin 343 par.2, lidhur me par.1 të KPK.

Nga leximi i evidencës së lëshuar nga Policia e Kosovës e datës 25.01.2017, së bashku me certifikatën për regjistrimin e automjetit me numër të targave 04-960-FB dhe nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, gjykata vërtetoi faktin se ishte konfiskuar përkohësisht automjeti Audi A3, ngjyrë hiri metalike, me targa .... çelësi i Audi A3 dhe certifikata e regjistrimit të automjetit CRA-0579744,

Nga leximi i procesverbalit mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit – dëshmitarit, e dhënë në prokurori me numër PP/II.nr.94-6/17, të datës 25.01.2017, gjykata vërtetoi faktin se këtu i padituri B.F. kishte dhënë deklaratë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, në cilësinë e të dëmtuarit.

Nga leximi i procesverbalit mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit – dëshmitarit, e dhënë në prokurori me numër PP/II.nr.94-6/17, të datës 07.02.2017, gjykata vërtetoi faktin se këtu i padituri B.F. kishte dhënë deklaratë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, në cilësinë e të dëmtuarit.

Nga leximi i procesverbalit mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit – dëshmitarit, e dhënë në Policinë e Kosovës, me datë 18.01.2017, gjykata vërtetoi faktin se këtu i padituri B.F. kishte dhënë deklaratë pranë Policisë së Kosovës, NJHKEK-Prizren, në cilësinë e dëshmitarit.

Nga leximi i procesverbalit mbi marrjen në pyetje të të pandehurit, me numër PP/II.nr.94-6/17, të datës 09.02.2017, gjykata vërtetoi faktin se këtu paditësi D.S. kishte dhënë deklaratë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, në cilësinë e të pandehurit.

Nga leximi i procesverbalit mbi intervistimin e të dyshuarit, e përpiluar pranë Policinë e Kosovës, me datë 18.01.2017, gjykata vërtetoi faktin se këtu paditësi D.S. kishte dhënë deklaratë pranë Policisë së Kosovës, NJHKEK-Prizren, në cilësinë e të dyshuarit.

### 3. Baza ligjore dhe Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore, si ligj i zbatueshëm është Ligji Për Marrëdhënien e Detyrimeve / Ligji Nr. 04/ L-077 10 maj 2012/ përkatësisht neni 194 paragrafi 1 ku ceket se “*Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur*” paragrafi 3 i të njëjtit nen dhe ligj “*Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket*”. Në këtë drejtim, kjo gjykatë vlerëson se për të ekzistuar pasurimi pabazë duhet të plotësohen katër kushte: që të ekzistoj pasurimi i cili mund të shprehet në rritjet të aktivitetit dhe zvogëlim të pasivitetit; që pasurimi të jetë shkaktuar në kurriz - dëm të personit tjetër

që mund të jetë i shprehur me kalimin e një pjese të pasurisë nga një person në personin tjetër, më pagesën e shumës e të hollave, në dorëzimin e ndonjë sendi apo më kryerjen e ndonjë veprimi; që të ekzistoi lidhja shkakore në mes të pasurimit dhe varfërimit; si dhe pasurimi duhet të jetë bërë pa bazë juridike apo në fillim gjegjësisht në krijimin e raportit të detyrimeve baza juridike ka ekzistuar mirëpo me kalimin e kohës ajo bazë ka dështuar. Në këtë rast, përgjatë kësaj procedure kontestimore është provuar fakti se paditësi D.S. nga fshati .... komuna e Suharekës, ia kishte dhënë të paditurit B.F. nga Prizreni shumën prej 4,000.00 euro, në emër të blerjes së automjetit Audi A3, i cili më vonë është sekuestruar nga ana e Policisë dhe i është kthyer këtu të paditurit, duke bërë kështu pasurimin e të paditurit dhe varfërimin e paditësit në shumën e lartcekur.

Gjykata vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit D.S. nga fshati .... komuna e Prizrenit dhe duke e detyruar të paditurin B.F. që në emër të pasurimit të pabazë ti kthej paditësit D.S. shumën prej 4,000.00 euro, kjo pasi që bazuar në provat e administruara, e veçanërisht deklarin e vet të paditurit B.F. në shqyrtimin kryesor të datës 29.06.2023, i cili ndër të tjera ka deklaruar se “4000 euro më janë dhënë kesh”, duke vërtetuar kështu faktin se i njëjti ka pranuar shumën prej 4,000.00 euro nga këtu paditësi, ndërsa gjykatës nuk i ka paraqitur ndonjë provë materiale me të cilën do të vërtetonte se shumën e lartcekur ia ka kthyer ndonjëherë paditësit. Gjykata konstaton se është vërtetuar fakti se i padituri është pasuruar në kurriz-dëm të këtu paditësit, kur me rastin e sekuestrimit të automjetit Audi A3 dhe kthimin e tij tek i padituri, paditësi është varfëruar në shumën prej 4,000.00 euro. Fakt ky i cili vërtetohet nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe nga deklarimi i të paditurit, i cili ka pohuar se automjeti i sekuestruar Audi A3, të cilin ia kishte shitur këtu paditësit, është kthyer tek i padituri. Ndërsa deklarimi i të paditurit se shuma prej 4,000.00 euro, i është dhënë në emër të automjetit Cady, nuk qëndron pasi që i njëjti gjykatës nuk ka arritur ti vërteton faktin se automjeti Cady i është dorëzuar këtu paditësit, përkatësisht nuk ekziston ndonjë marrëveshje në formë të shkruar lidhur me shitblerjen e tij, andaj gjykata nga deklarimi i paditurit ka konstatuar faktin se i paditurit ka pranuar shumën prej 4,000.00 nga këtu paditësi e në kuptim të nenit 321.2 të LPK-së nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar gjatë procesit gjyqësor. Ndërsa pretendimi i të paditurit se për shumën prej 4,000.00 euro këtu paditësi ka pranuar automjetin Cady, i padituri me asnjë provë nuk ka arritur që të provoj këtë fakt, e në kutim të nenit 322.3 të LPK-së barra e të provuarit bie mbi palën e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte.

Gjykata e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 9,000.00 euro, sepse me asnjë provë nuk është provuar fakti se ka ekzistuar ndonjëherë detyrimi në të holla mbi shumën prej 4,000.00 euro. Shuma e pretenduar prej 5,000.00 euro, për të cilën paditësi pretendon se ia kishte pasur borxh këtu i padituri, për kompensimin e të cilave i padituri ia kishte dhënë automjetin Audi A3, e i cili më vonë është sekuestruar nga ana e policisë, në procedurën penale ndaj këtu paditësit, nuk vërtetohet me asnjë provë, deklarinmet e këtu paditësit nuk gjejnë mbështetje në ndonjë provë tjetër dhe që në ndërlidhje me to do të vërtetohet fakti se kjo shumë e përmendur nga ai i është dhënë të paditurit. Andaj, në mungesë të provave mbështetëse nuk është vërtetuar fakti i ekzistimit të borxhit të paditurit ndaj paditësit në shumën prej 5,000.00 euro. Po ashtu me nenin 7.1 të LPK-së është

paraparë se "Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla". Në këtë drejtim gjykata i referohet edhe nenit 319 ku secila nga palët ndrëgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta dhe 322 të LPK-së, për pjesën refuzuese të padisë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (31.12.2018), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020, të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse

Gjykata vendosi si në pikën V të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurin B.F. nga Prizreni, ti paguaj paditësit D.S. shpenzimet procedurale dhe atë konform nenit 449, 452 par.1, lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, si dhe në bazë të TA-së, dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro, për taksën gjyqësore shumën prej 60.00 euro, për 4 seanca të mbajtura shumën prej 540.00 euro (4x135.00), për 1 seancë të shtyrë shumën prej 67.50 euro, e në shumë të përgjithshme prej 771.50 (shtatëqind e shtatëdhjetenjë) euro. Pjesën tjetër të kërkesës së paditësit për kompensimin e shpenzimeve procedurale edhe për 3 seanca tjera të shtyra, gjykata e vlerësoi si të pabazuar për faktin se të njëjtat janë shtyrë pa fajin e këtu të paditurit.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 194 par.1 dhe 3 të LMD-së, lidhur me nenin 143 LPK-së, gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.2076/2018, datë 01.08.2023**

**G j y q t a r i**

**Taulant Rexhëbeqaj**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, drejtuar Gjykatës e Apelit e Kosovës, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.